



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 629/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.09.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “Rroku Guest” shpk si dhe anulimin e procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-22822-05-20-2019, me objekt: “Shërbime riparimi të akseve të rrugëve: (Riparimi dhe mirmbajtje e aksit rrugor Ura Mesit-Prekal-Kir-Breglumi-Ndërlysj) dhe (Riparim dhe mirmbajtje e aksit rrugor Qafe Thore-Thethë-Ndërlysj)”, me fond limit 3,660,225 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 13.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

Ankimues: “Blinishta” shpk
Adresa: Omaraj-Gruemirë-Malësi e Madhe, Shkodër.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Shkodër
Adresa: Rruga “13 Dhjetori”, Nr. 1, Shkodër.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, pretendimet e tij dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky operator ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 21.05.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-22822-05-20-2019, me objekt: “*Shërbime riparimi të akseve të rrugëve: (Riparimi dhe mirmbajtje e aksit rrugor Ura Mesit-Prekal-Kir-Breglumi-Ndërlysj) dhe (Riparim dhe mirmbajtje e aksit rrugor Qafe Thore-Thethë-Ndërlysj)*”, me fond limit 3,660,225 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 13.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

II.2. Në datën 13.06.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.) rezulton se në datën 22.07.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Nika” shpk	3,386,000 lekë	skualifikuar
2. “Rroku Guest” shpk	3,435,900 lekë	kualifikuar
3. “Blinishta” shpk	3,439,945 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 22.07.2019, operatori ekonomik “Blinishta” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyen se:

- Oferta juaj skualifikohet.
- Në ofertën tuaj nuk keni paraqitur preventivin e punimeve vetëm për segmentin Qafthore-Theth-Ndërlyshaj në kundërshtim me preventivat e publikuar nga AK, ku janë publikuar dy preventiva për tu plotësuar për segmentin Ura e Mesit-Prekal-Kir-Breglumi-Ndërlyshaj dhe segmentin Qafthore-Theth-Ndërlyshaj.

II.4.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se në datën 26.07.2019, operatori ekonomik “Blinishta” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmblendhur me argumentet si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik “Blinishta” sh.p.k. ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit të zhvilluar me datë 13.06.2019 nga Bashkia Shkoder me objekt “Sherbime riparimi të akseve të rrugëve (Riparimi dhe mirmbajtje e aksit rrugor Ura Mesit-Prekal-Kir-Breglumi-Ndërlyshaj) dhe (Riparim dhe mirmbajtje e aksit rrugor Qafe Thore-Thethë-Ndërlyshaj)”, me fond limit 3,660,225 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 13.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

Me datën 22.07.2019 njoftohemi nepermjet mesazhit elektronik në llogarinë tonë në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimeve Publike me Vendimin e Komisionit të Vleresimit të Ofertave të Bashkisë Shkoder. Ky vendim bën vlerësimin e procedurës, kuotimin e operatoreve ekonomik pjesëmarrës .

Renditja është perkatesisht si më poshtë:

1.	“Nika” shpk	3,386,000 lekë	skualifikuar
2.	“Rroku Guest” shpk	3,435,900 lekë	kualifikuar
3.	“Blinishta” shpk	3,439,945 lekë	skualifikuar

Se pari:

Vlerësimi i ofertave është bërë në kundërshtim të plotë me ligjin nr.9643 dt.20.11.2006 për prokurimet publike dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pasi ka bërë vlerësimin e ofertave 39 dite pas hapjes së ofertave ndërkohe që ligji parashikon 15 dite si afatin maksimal për vlerësimin e ofertave. (Hapja e tenderit me datë 13.06.2019 dhe vlerësimi me datë 22.07.2019) Në nenin 66 të “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik (i ndryshuar) thuhet se : “Kohezgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 15 (pesëmbëdhjetë) dite, përveç rasteve të tjera të cilesuara ndryshe në këtto rregulla”. Pra afati i vlerësimit nga 15 dite ka shkuar në 39 dite duke e tejkaluar afatin me 24 dite, në kundërshtim të plotë me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

Se dyti:

Kualifikimi i operatorit ekonomik “Rroku Guest sh.p.k është i padrejtë dhe në kundërshtim të plotë me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik pasi ky operator nuk i plotëson kriteret për

kualifikim 2.3 Per kapacitetin teknik: pika 3 “Operatori ekonomik ofertues duhet te kete numrin e nevojshem te punonjesve per realizimin dhe zbatimin e kontrates. Numri mesatar i punonjesve te siguruar per periudhen Janar 2019 - Prill 2019 duhet te jete 15 (Pesemebdhjete). Keta punonjes nuk duhet te jene te angazhuar ne kontrate/kontrata te tjera si kontraktor apo nenkontraktor per te njejten periudhe te zbatimit te kontrates qe po prokurohet me Autoritetin Kontraktor Bashkia Shkoder. (Deklarate nga administratori i shoqerise). Pasi kjo shoqeri ne daten e dorezimit te ofertes vetem me Bashkine Shkoder per vitin 2019 ka te angazhuar fuqi punetore ne disa kontrata ne proces qe e tejkalojne nr. e punonjesve qe disponon kjo shoqeri. (Gjithashtu ka kontrata dhe me institucionet e tjera si Bashkia Vau Dejes, Drejtoria e Ujities dhe Kullimit Lezhe, Ministria e Bujqesise, Drejtoria Rajonale e Oshe Sh.A Burrel e Kontratat ne proces me Bashkine Shkoder per vitin 2019.

Nr	ROKU GUEST	Autoriteti Kontraktor	Viera fituese	fuqia punetore
1	Rikonstruksion Degezime Rruga e “Shirokes”,	Bashkia Shkoder	9,263,144	20
2	Sistemim - Asfaltim i rruges se Varrezave te Fshatit Mali – Hebaj”.	Bashkia Shkoder	10,286,842	25
3	Sistemim - Asfaltim i Rruges Berdice e siperme	Bashkia Shkoder	5,636,362	15
4	Rikonstruksion Rruga Gjergj Jakin Berclice e Siperme, rruga e Palokajve Berdice e Madhe	Bashkia Shkoder	13,987,856	15

Se treti:

Kualifikimi i operatorit ekonomik “Rroku Guest” sh.p.k eshte i padrejte dhe ne kundersizim te plote me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik pasi ky operator nuk i ploteson kriteret per kualifikim 2.3 Per kapacitetin teknik: pika 8 “Ofertuesi duhet te disponoje minimalisht mjetet e meposhtme per kryerjen e punimeve, me qellim realizimin e objektit te prokurimit”:

Nr	Mjetet	Sasia
1	Mjet transporti vetshkarkues 5 ton (ngarkesa)	2 cope
2	Eskavator me goma 0.25m3	2 cope
3	Eskavator me zinxhire 0.35 m 3 - 0.4m3	2 cope

Pasi makinerite e paraqitura nga ky operator jane te deklaruar edhe ne kontratat e tjera te paraqitura me siper me Bashkine Shkoder ne kundersizim me kriterin:

1. Operatori ekonomik ofertues (Administratori i shoqerise ofertuese), duhet te paraqese nje deklarate qe makinerite e kerkuara ne piken 2.3.8, nuk duhet te jene te angazhuara ne ndonje kontrate/kontrata te tjera ne fuqi, dhe nuk jane te deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga Autoritetin Kontraktor Bashkia Shkoder, por vetem per kete objekt. Gjithashtu ne

deklarate duhet te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi. Komisioni i vleresimit te ofertes i lind e drejta per te verifikuar ne kantier disponueshmerine e makinerive te deklaruar.

Bazuar sa me siper nuk jemi dakort me kete vendimarrje te gabuar dhe te kundraligjshme te bere nga KVO e Bashkia Shkoder ne lidhje me proceduren e ndjekur nga komisioni per vleresimin e ofertave dhe me kualifikimin e operatorit ekonomik “Rroku Guest” sh.p.k, pasi i njejti institucion perdor dy standarte ne vleresimin e ofertave duke patur parasysh qe per kete arsye jane skualifikuar operator te tjere ekonomik ne procedurat e mepareshme.

Sa me siper kerkojme nga ana juaj te rivleresohet kjo procedure prokurimi, te skualifikohet operatori ekonomik “Rroku Guest” sh.p.k dhe te behet anullimi i kesaj procedure prokurimi.

Ne rast te kundert jemi te detyruar tu drejtohem organeve me te larta administrative dhe gjyqesore per te vene ne vend te drejtat e shkelura ne lidhje me barazine ne tendera.

II.4.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe dokumentacionit të paraqitur nga ankimuesi më anë të ankesës rezulton se autoriteti kontraktor nuk i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues.

II.4.3. Në datën 09.08.2019 operatori ekonomik ankimues “Blinishta” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 14305/1 prot., datë 27.08.2019, protokolluar me tonën me numër 1387/2 prot., datë 04.09.2019, me objekt “Informacion” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Blinishta” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “Rroku Guest” sh.p.k. si dhe anulimin e procedurës së prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se::

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se në datën 22.07.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të

prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1.	<i>“Nika” shpk</i>	3,386,000 lekë	skualifikuar
2.	<i>“Rroku Guest” shpk</i>	3,435,900 lekë	kualifikuar
3.	<i>“Blinishta” shpk</i>	3,439,945 lekë	skualifikuar

III.1.2. Rezulton se në ankesën e datës 26.07.2019 drejtuar autoritetit kontraktor operatori ekonomik ankimues *“Blinishta” shpk* ka ngritur pretendime lidhur me vlerësimin e procedurës, si dhe kualifikimin e operatorit ekonomik *“Rroku Guest” shpk*, konstatohet se edhe në ankesën e datës 09.08.2019 drejtuar KPP operatori ekonomik ankimues ngre të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor. Ankimuesi në asnjë moment nuk ka pretenduar kualifikimin e ofertës së tij dhe nuk ka kundërshtuar shkaqet e veta të skualifikimit si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor ashtu dhe në atë pranë KPP, por ka kundërshtuar kualifikimin e operatorit ekonomik *“Rroku Guest” shpk* si dhe ka kërkuar anulimin e procedurës së prokurimit.

III.1.3. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar, *“Të drejtat e personit të interesuar”* parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”* Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi është i papranueshëm. Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, duhet të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk ka ndonjë interes të ligjshëm për të mbrojtur. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk arrin të realizojë interesin e tij të ligjshëm. Duke analizuar rastin në shqyrtim, në kontekst të këtij precedenti, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues *“Blinishta” sh.p.k.* nuk legjitimohet pasi, interesi i tij i ligjshëm, nuk ka sesi të dëmtohet nga dështimi i operatorit ekonomik *“Rroku Guest” sh.p.k.* në këtë procedurë prokurimi. Theksojmë se, në klasifikimin e datës 22.07.2019, të dhënë nga vlerësimi i KVO-së për këtë procedurë prokurimi, konstatohet se operatori ekonomik *“Blinishta” sh.p.k.* është i skualifikuar. Pra përse i përket pretendimit të ankimuesit për skualifikimin e operatorit ekonomik *“Rroku Guest” sh.p.k.*, konstatojmë se ankimuesi është i skualifikuar nga autoriteti kontraktor që në vlerësimin e bërë prej tij në datën 22.07.2019, e si rrjedhim, kjo gjë nuk sjell ndonjë interes në favor të tij. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*) nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi. Kjo praktikë e KPP tashmë

është konsoliduar edhe nga vendimmarrja gjyqësore, duke u lënë në fuqi përmes vendimesh përfundimtare.

III.1.4. Komisioni pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues lidhur me anulimin e procedurës dhe të fazës së vlerësimit të ofertave gjykon se autoriteti kontraktor nuk ka kryer shkelje procedurale të cilat të ketë penguar ankimuesin në ushtrimin e të drejtës së tij të ankimimit lidhur me kriteret kualifikuese dhe akoma më tej të kenë penguar operatorin të marrë pjesë në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Në asnjë rast ankimuesi nuk argumenton se cili veprim i autoritetit kontraktor ka cënuar pozitën e tij dhe është bërë pengesë lidhur me pjesëmarrjen e tij në procedurë sa kohë rezulton e provuar se ai ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit objekt ankimi. KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk legjitimohet në kërkesën e tij për anulim procedure pasi vetë fakti që operatori ekonomik ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit objekt ankimi, dëshmon se ka qenë dakord me kriteret e vendosura për sa kohë nuk ka ushtruar më tej të drejtën për ankim edhe pse kishte mundësinë e ushtrimit të kësaj të drejte brenda afateve të caktuara në LPP, si më sipër cituar.

Rrjedhimisht, pretendim i operatorit ekonomik “*Blinishta*” sh.p.k. nuk legjitimohet dhe nuk merret në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Blinishta*” shpk për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-22822-05-20-2019, me objekt: “*Shërbime riparimi të akseve të rrugëve: (Riparimi dhe mirmbajtje e aksit rrugor Ura Mesit-Prekal-Kir-Breglumi-Ndërlysj) dhe (Riparim dhe mirmbajtje e aksit rrugor Qafe Thore-Thethë-Ndërlysj)*”, me fond limit 3,660,225 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 13.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 1387 Protokolli, Datë 09.08.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

NënKryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha